



# DITA NDËRKOMBËTARE E GRUAS

Festimi i suksesit dhe pranimi i përfshirjes  
me Projektin për Rekrutime në Pozita të Larta  
në Kosovë

Mars 2024



Ambasada Britanike  
Prishtinë

 **TALOGY**

IDEAS | PEOPLE | TRUST

## Shikimi me lente gjinore - mbështetja e projektit tonë për Rrjetëzimin e Grave në Kosovë

Viteve të fundit që nga fillimi i projektit, Anne Stratton dhe Edmonda Kelmendi (konsultante në BDO) kanë mbështetur themelimin e 'Rrjetit për Fuqizimin e Grave në Pozita Vendimmarrëse në Sektorin Publik' në Prishtinë, Kosovë.

Qëllimi i Rrjetit është të bashkojë gratë, duke u ofruar atyre mundësi për të mësuar, për t'u lidhur dhe për të lulëzuar së bashku. Në mënyrë të veçantë, ne donim të inkurajonim gratë që të aplikojnë dhe të lulëzojnë në role vendimmarrëse kryesore në institucionet qendrore publike dhe të pavarura.

Rrjeti shquhet për disa arsye:

1. Biseda frymëzuese: Pjesëmarrësit angazhohen në dialogje që provokojnë mendime, duke fituar perspektiva (këndvështrime) dhe njohuri të reja.
2. Rrjetet dhe marrëdhëniet e dobishme: Ne kultivojmë lidhje që shtrihen përtej ngjarjeve, duke krijuar një komunitet mbështetës.
3. Ndërtimi i besimit: Njëpërmjet përvojave të përbashkëta dhe inkurajimit, gratë ndërtojnë besimin dhe vendosmërinë e tyre.
4. Temat e Diversitetit dhe Përfshirjes: Ne eksplorojmë çështje jetike, duke mbrojtur diversitetin dhe duke frymëzuar besim tek të gjithë pjesëmarrësit.



Ngjarja e Rrjetit të Grave që sjellë lidere të larta nga institucionet publike të Kosovës



Anëtarët e Komitetit të Rrjetit të Grave me Ambasadorin Britanik në Kosovë, Nicholas Abbott (lart)

Anëtarët e Komitetit të Rrjetit të Grave takohen me vajza të reja për të diskutuar rëndësinë e grave që udhëheqin dhe frymëzojnë udhëheqjen (më poshtë)



Një ngjarje inauguruese u zhvillua në tetor 2023, ku u angazhuam në diskutime të sinqerta rreth sfidave të karrierës, ndamë përvoja të vlefshme dhe identifikuam mënyra për të mbështetur njëra-tjetrën.

Një ngjarje e dytë në shkurt 2024 ishte një simbol i jashtëzakonshëm i bashkëpunimit gjithëpërfshirës: Rrjeti bashkoi forcat me konkursin "Bëhu ambasadore për një ditë" të Ambasadës Britanike për vajzat e reja, ku pjesëmarrëset diskutuan kuptimin e "lidërsipit frymëzues" dhe pse gratë duhet gjithashtu të bëhen udhëheqëse (lidere).

**"Së bashku, ne po përpiqemi të ngremë zërin dhe ndikimin e grave në vendimmarrje."**

# Festimi i suksesit dhe pranimi i përfshirjes me Rrjetin tonë të Fuqizimit të Grave në Pozita Vendimmarrëse në Sektorin Publik



Tema e Ditës Ndërkombëtare të Gruas të këtij viti është #InspireInclusion, dhe ne kemi kënaqësinë të paraqesim gjetjet nga takimi ynë i fundit i Rrjetit të Grave, ku fryma e përfshirjes vërtetë ka shkëlqyer.

**Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme,** mbajti një fjalim me ndikim mbi rëndësinë e përfshirjes në Zyrën Kombëtare të Auditimit në Prishtinë. Ajo mbrojti praktikat gjithëpërfshirëse, modelet e roleve dhe stilet e lidershit demokratik që nxisin përgjegjshmërinë për realizim. Vlora ndau rrugëtimin e saj personal në ndërtimin e një kulture të vendimmarrjes bashkëpunuese dhe foli për ndikimin pozitiv në besimin, performancën si dhe mirëqenien e ekipit.

Duke iu drejtuar audiencës së grave, Vlora theksoi rëndësinë e drejtësisë dhe barazisë për të gjithë, duke theksuar se përfshirja tejkalon gjininë, moshën dhe paragjykimet e tjera të mundshme. Ajo foli për qasjet e përdorura për t'i ftuar të gjithë që të flasin dhe të ndihen të vlerësuar, duke treguar për ndikimin e çiltërsisë dhe performancës së përmirësuar. Ndikimi në Zyrën Kombëtare të Auditimit ka rezultuar që njerëzit të jenë më shumë të motivuar, më të shkathët dhe të kenë një ndjenjë të vërtetë përgjegjësie.

Shkëmbimi i mëvonshëm i ideve dhe përvojave tregoi vërtetë fuqinë e bashkëpunimit midis grave.

Diskutimet fillestare ishin me theks në kulturën e përgjithshme ndaj grave në vendet e punës në Kosovë: përgjithësisht u ndje se kontributet profesionale të grave ishin nënvlerësuar dhe sjelljet ndaj grave ndonjëherë ishin përjashtuese. U dhënë shembuj se si këto përkthehen në praktikë, të tilla si delegimi i padrejtë i detyrave ose përjashtimi i grave

Në proceset vendimmarrëse.

Nën-përfaqësimi i grave në pozitat e larta dhe disa nga sjelljet vetëkufizuese të grave që ngurrojnë të bëjnë hapa përpara u perceptuan gjithashtu si faktorë kufizues për tërheqjen, rekrutimin dhe emërimin e grave në pozita të larta drejtuese.

Më pas kemi shqyrtuar se si gratë mund të promovojnë në mënyrë aktive një kulturë të përfshirjes:

- Të fuqizojmë veten dhe të tjerët për të udhëhequr dhe raportuar pabarazinë kur dhe kur e përjetojmë atë;
- Veprojmë me integritet për t'i trajtuar të gjithë me respekt dhe dinjitet për të ndaluar diskriminimin;
- Zhvendosim dialogun në vendin e punës drejt gjithëpërfshirjes, edukojmë liderët për drejtësinë dhe si të arrihet besimi;
- Inkurajojmë punën në grup, ofruar mbështetje dhe trajnime për drejtuesit dhe anëtarët e ekipit;
- Bëjmë rishikime të drejta të performancës, bazuar në vlerësimet e sakta të kompetencave;
- Krijojmë forume ku temat e biznesit mund të diskutohen në detaje në çdo nivel biznesi.



vazhdim...

Kur shqyrtoam përfitimet e kësaj qasjeje, u ndjemë të frymëzuara nga mundësitë e ardhshme të një vendi pune më gjithëpërfshirës.

Të gjitha ramë dakord se donim të punonim aty ku ka drejtësi, besim dhe respekt dhe shqyrtoam përfitimet shtesë. Arritëm në përfundim se ofrimi i mundësive të barabarta të delegimit do të motivojë stafin për të përmbushur objektivat dhe do t'i inkurajojë ata të shprehin idetë e tyre. Kjo qasje proaktive do të minimizonte mikromenaxhimin, do të çonte në vendimmarrje dhe bashkëpunim më të mirë. Nga ana tjetër, do të arriheshin më shumë qëllime, do të përmbusheshin më shumë objektiva të performancës dhe qëndrueshmëria dhe performanca e organizatës do të përmirësoheshin ndjeshëm.

Pas diskutimeve tona të tryezës së rrumbullakët me të vërtetë frytdhënëse, ishte e qartë se përfshirja nuk është vetëm një fjalë koti për ne; por është një parim udhëzues. Ajo formon kulturën tonë organizative, na shtyn drejt një të ardhmeje më të larmishme, të barabartë dhe bashkëpunuese.

**#InspireInclusion është një strategji qenësore për të ardhmën.**

**Në emër të BDO dhe Projektit për Rekrutime në Pozita të Larta në Kosovë, Urime Dita Ndërkombëtare e Gruas!**



Për më tepër informata rreth projektit dhe qasje në resurset kryesore mbështetëse, vizitoni:

[www.kosovoselection.org](http://www.kosovoselection.org)